



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____ 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: : “Ushqime për fëmijë”, i ndarë në 5 lote

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Ushqime për fëmijë 15884000-8

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.066.450 (pesë milion e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa tvsh, i ndarë në 5 lote si më poshtë:

Loti 1: “Blerje bukë “ me nr. REF- 97971-03-11-2024 me fond limit 560.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

Loti 2: “Blerje qumësht dhe nënprodukte të tij” me nr. REF- 97973-03-11-2024 me fond limit 1,333.330 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mije e treqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

Loti 3: “Blerje vezë, fruta, perime” me nr. REF -97975-03-11-2024 me fond limit 1.116.290 (një milion e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh

Loti 4: “Blerje mish dhe nënprodukte të tij” me nr. REF- 97977-03-11-2024 me fond limit 1.156.830 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh

Loti 5: “Blerje ushqime koloniale” me nr. REF-97979-03-11-2024 me fond limit 900.000 (nëntëqind mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim Oferte, sipas Shtojcës 3;*

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, neneve 26 dhe 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës të lotit/lotëve për të cilin/cilët konkurron.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, minimalisht xhiro vjetore e njërit prej viteve të periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e ulët se shuma e vlerave të kërkuara të xhiros minimale, të lotëve për të cilët OE/BOE rezulton fitues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM “Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor. **Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt i kontratës.**

2.2.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 2 vitet e fundit financiare (2021-2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. (Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar

“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese. **Ky kriter është i njëjtë për të 5 lotet objekt i kontratës.**

2.2.3 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të deklarojë që ka shlyer të gjitha taksat dhe tarifat vendore leshuar nga të gjitha Njësitë Vendore ku Operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024, për të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të cilat duhet të paraqesi një vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin sipas përcaktimeve të Ligjit nr.Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. *(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).* Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me paraqitjen e një deklaratë. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

Argumentimi: Janë kërkuar këto kritere në përputhje me nenin 77, pika 5 të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2021 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së. **Ky kriter është i njëjtë për të 5lotet objekt i kontratës.**

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të lotit/loteve për të cilin/cilët konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit/lotëve për të cilin/cilët konkuron, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- 2.3.2 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë që produktet e kërkuara plotësojnë standartet në fuqi për sigurinë ushqimore.
- 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës duhet të vetdeklarojë se, nga kontrolli i fundit i ushtruar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitetet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në **Rekomandim nr. 10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit. Ky kriter është i njëjtë për të 4 lotet objekt i kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet për kryerjen e furnizimit të ushqimeve të lotëve 1, 3. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. *Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.*

2.3.5 Operatorët Ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë një automjet frigoriferik për kryerjen e furnizimit të ushqimeve të lotëve 2, 4. Për të vërtetuar këtë fakt duhet të paraqesë kopje të lejes së qarkullimit, siguracionit, pagimin e taksave vjetore, kryerjen e kontrollit teknik vjetor, si dhe lejen higjieno sanitare. *Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.*

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur bazuar në **Rekomandim nr.10181 prot., datë 19.11.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”** të hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.

Bazuar në parashikimet e Rr.P.P. miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe

dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Vlorë është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit. Nga ky grup janë hartuar sipas shkresave bashkëlidhur dhe është mbajtur procesverbali përkatës.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT